

THIRRJE E HAPUR: Programi i trajnimit për ngritje të kapaciteteve Manifesta 14

Manifesta 14 Prishtinë - Manifesta 13 Marsejë

Hyrje

Manifesta, Bienalja Nomadike Evropiane, prodhon një nga ngjarjet më me ndikim të artit në botë. Manifesta lindi në fillim të viteve 1990 si përgjigje ndaj ndryshimit politik, ekonomik dhe shoqëror pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe hapave pasues drejt integritimit evropian. Që atëherë, Manifesta është zhvilluar në një platformë për dialog midis artit dhe shoqërisë duke ftuar komunitetin kulturor dhe artistik të prodhojë përvoja të reja krijuese me dhe për kontekstin në të cilin zhvillohet. Manifesta rishikon marrëdhëniet midis kulturës dhe shoqërisë duke hulumtuar dhe katalizuar ndryshimin pozitiv shoqëror në Evropë përmes kulturës bashkëkohore në një dialog të vazhdueshëm me sferën sociale të një vendi specifik.

Fondacioni Manifesta 14 Prishtina (FM14) zhvillon edicionin e 14-të të Manifestës në vitin 2022 së bashku me Qytetin e Prishtinës. Programi i Trajnimit të Kapaciteteve është zhvilluar në bashkëpunim me Manifesta 13 Marseille për të përgatitur katër profesionistë në rolin e tyre të ardhshëm si koordinatore për FM14 në Prishtinë. Programi intensiv 10-javor zhvillohet nga mesi i shtatorit deri në fund të nëntorit 2020 në Marsejë dhe përfshin dy prej fundjavave të hapjes (25 shtator dhe 9 tetor 2020) si dhe ceremoninë e mbylljes në 29 nëntor 2020.

Qëllimi kryesor i programit është që koordinatorët e ardhshëm të punojnë nga afër me homologët e tyre në Marsejë, të mësojnë rreth organizatës, historinë dhe metodologjitë e saja dhe ritmin e punës në mënyrë që të jenë plotësisht të përgatitur si koordinatore lokal për Manifesta 14 në Prishtinë.

Kandidatët do të përzgjidhen në bazë të një përshkrimi të punës të hartuar nga departamentet:

- [Koordinatorja e Produksionit Manifesta 14](#), e kryesuar nga Tatiana Tarrago
- [Koordinatorja e zhvillimit M14](#), e kryesuar nga Marieke van Hal
- [Koordinatorja e Hulumtimit M14](#), e drejtuar nga Yana Klichuk
- [Koordinatorja për komunikim dhe marketing M14](#), e kryesuar nga Emilia van Lynden

Pjesëmarrja në program ofrohet në kushtet e mëposhtme:

- Vendndodhja e punës: Marsejë
- Koha e plotë: 15 Shtator 2020 deri më 29 Nëntor 2020
- Shpenzimet e banimit në Marsejë
- Shpenzimet e udhëtimit nga dhe për në Prishtinë (1 fluturim kthimi)
- Sigurim shëndetsor
- Tarifa e vizave (Tarifa e vizës Shengen 90 ditë)
- Paga në përputhje me përvojën

Kohështrirja

Hapja e thirrjes së hapur 10 korrik 2020

Afati i fundit për aplikim 03 gusht 2020

Intervistat 10-14 gusht 2020

Fillimi i Programit të Trajnimit të Kapaciteteve 15 Shtator 2020

<https://manifesta.org/2020/07/open-call-capacity-training-programme/>